



Periodiku AMF

I. Filloi Projekti FIRST në bashkëpunim me Bankën Botërore

Banka Botërore është duke asistuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për të përforcuar metodologjinë e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, me qëllim kalimin në një përjasje me bazë riskun.

Për këtë qëllim, dy ekspertë kanadezë, Z. Frank Mackowiak dhe Z. John R. Thompson, me eksperiencë të gjatë në fushën e sigurimeve dhe në mbikëqyrjen e sigurimeve, janë caktuar për njohjen e situatës në vend dhe dhënien e rekomandimeve për mënyrën e arritjes së qëllimit të këtij projekti.

Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura II.1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-korrik 2008

Në periudhën janar - korrik 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 4,021,420 mijë lekë, përkundrajt 3,442,749 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 16.81 % nga viti i kaluar, ku 86.51 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 13.49 % tregut të sigurimeve të Jetës.

Vijon në faqen 2

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera III.1 AXCO publikon raportin e saj të fundit mbi tregun e sigurimeve të jo - jetës në Shqipëri

Kompania Britanike AXCO, e specializuar në

analizën e tregjeve, ka nxjerrë raportin e saj të ri mbi tregun e sigurimeve të jo - jetës në Shqipëri. Raportet e kompanisë AXCO hartohen nga profesionistë të sigurimeve me përvojë, ndërsa përdorin si burim të informacionit pjesëmarrësit kryesorë të tregjeve. Raporti i fundit për Shqipërinë është shkruar nga Tim Beauchamp, nga tregu i Londrës dhe me përvojë të gjatë në vendet e Evropës së 're' dhe të Azisë Qendrore.

Vijon në faqen 4

...Vijon nga numri i kaluar

IV. Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

Shënime të udhëzimeve për licencimin e instituteve të pensionit.

III. Kërkesat për licencim

1. Dispozitat ligjore mbi licencimin

1. Në interes të transparencës, të vërtetësisë ligjore dhe qëllimeve të përmendura në parathënie të këtyre udhëzimeve, rregullat e licencimit përcaktohen me anë të legjislacionit. Dispozitat ligjore përcaktojnë strukturën e procesit të licencimit dhe gjithashtu përcaktojnë kompetencat, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proces. Dispozitat ligjore përgjithësisht ndikojnë vetëm në institutet e pensionit, por në disa juridiksione ato aplikohen edhe nga planet e pensionit, veçanërisht kur çdo plan është i lidhur me një institut të vetëm pensioni.

Vijon në faqen 8

Në këtë numër:

Filloi Projekti FIRST në bashkëpunim me Bankën Botërore

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

2

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

4

Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

8

Filloi Projekti FIRST¹ në bashkëpunim me Bankën Botërore

Banka Botërore është duke asistuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për të përforcuar metodologjinë e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, me qëllim kalimin në një përqsasje me bazë riskun.

Për këtë qëllim, dy ekspertë kanadezë, Z. Frank Mackowiak dhe Z. John R. Thompson, me eksperiencë të gjatë në fushën e sigurimeve dhe në mbikëqyrjen e sigurimeve, janë caktuar për njohjen e situatës në vend dhe dhënien e rekomandimeve për mënyrën e arritjes së qëllimit të këtij projekti. *Projekti ka si objekt mbikëqyrjen efektive të sigurimeve, rishikimin e bazës ligjore dhe përbëhet nga dy pjesë:*

- (1) Mbikëqyrja efektive nëpërmjet zhvillimit të një mbikëqyrje me bazë risku;
- (2) Rishikimi i legjislacionit në fushën e sigurimeve.

Kështu në datat 06 -21 Gusht 2008, në ambientet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u zhvillua dhe faza e parë e projektit, ku ekspertët kanadezë zhvilluan takime dhe biseda me përfaqësues të Departamentit të Mbikëqyrjes, si dhe me përfaqësues nga tregu i sigurimeve, me qëllim njohjen dhe vlerësimin e përqsajes aktuale të mbikëqyrjes së sigurimeve në Shqipëri.

Objektivat kryesore të këtij projekti janë:

- *Promovimi i një tregu eficient sigurimesh, të sigurt dhe të qëndrueshëm, me qëllim mbrojtjen e policmbajtësve;*
- *Dizenjimi i një metodologjie efektive të mbikëqyrjes me bazë risku dhe të një*

platforme mbikëqyrjeje efikase;

- *Rritja e kapaciteteve të AMF për të vlerësuar risqet e pjesëmarrësve të tregut, përdorimi eficient i burimeve dhe vendosja e prioriteteve të ndërhyrjes;*
- *Forcimi i kuadrit rregullativ dhe i mbikëqyrjes së sigurimeve;*
- *Rritja e kapaciteteve rregullative dhe institucionale të AMF; si dhe Rishikimi i bazës ligjore për tregun e sigurimeve.*

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

I. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-korrik 2008

Në periudhën janar – korrik 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 4,021,420 mijë lekë, përkundrejt 3,442,749 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 16.81 % nga viti i kaluar, ku 86.51 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 13.49 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 34.92% të sigurimeve të Jetës dhe 15.55 % të sigurimeve të Jo Jetës.

Në periudhën janar – korrik 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 3.67 %, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 42.05 %.

Në periudhën janar – korrik 2008 u lidhën 358,574 kontrata sigurimi, përkundrejt 301,342


¹ Financial Sector Reform and Strengthening Initiative

kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 328,580 nga 280,936 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL shënoi rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 12,869 kontrata ose në masën 10.36% më shumë se janar – korrik 2007.


Vlen të përmendet rritja në masën 46.99 % e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 29,994 nga të cilat sigurimi “Jetë Debitori” ka një rritje prej 4,322 kontrata ose 41.38 %, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - korrik 2008 kapi vlerën 732,455 mijë lekë, ose 14.13 % më pak se në janar - korrik të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 601,655 mijë lekë, apo 84.70 % të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në portofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 46.07 % dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 36.19 % krahasuar me 7 mujorin e parë të vitit 2007.

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhë janar – korrik 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar – korrik 2008 (Jo Jeta)



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - korrik (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2007	2008
<i>Periudha janar - korrik</i>		
A) Sigurim i Jetës	223,659	301,751
B) Sigurim i Jo Jetës	3,219,090	3,719,669
<i>nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	2,222,447	2,303,931
b) Sigurimi Vullnetar	996,643	1,415,738

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

I. AXCO publikon raportin e saj të fundit mbi tregun e sigurimeve të jo – jetës në Shqipëri

Kompania Britanike AXCO, e specializuar në analizën e tregjeve, ka nxjerrë raportin e saj të ri mbi tregun e sigurimeve të jo - jetës në Shqipëri. Raportet e kompanisë AXCO hartohen nga profesionistë të sigurimeve me përvojë, ndërsa përdorin si burim të informacionit pjesëmarrësit kryesorë të tregjeve. Raporti i fundit për Shqipërinë është shkruar nga Tim Beauchamp, nga tregu i Londrës dhe me përvojë të gjatë në vendet e Evropës së 're' dhe të Azisë Qendrore.

Raporti përbëhet nga katër pjesë, përkatësisht:

1. të dhëna të përgjithshme demografike, politike dhe ekonomike;
2. rregullimi dhe mbikëqyrja;
3. pjesëmarrësit në treg; dhe
4. produktet e sigurimeve.

Raporti është mjaft i detajuar dhe bën një përmbledhje të mirë të tregut nëpërmjet komenteve, statistikave kryesore dhe grafikëve të shumtë. Ai nënvizon rolin e Autoritetit në zhvillimin e një tregu të shëndetshëm të sigurimeve në Shqipëri. Potenciali i madh i tregut të sigurimeve përcaktohet si faktor themelor në tërheqjen e interesit të kompanive ndërkombëtare për të investuar në Shqipëri.

Më poshtë do të lexoni një pjesë të shkëputur nga ky raport

Zhvillimet e Tregut

o Më datë 10.09.2006 hyri në fuqi Ligji Nr. 9572 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Ligji i ri përqëndroi në një institucion të vetëm, në atë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), funksionet rregullatore të ushtruara deri në këtë fazë veçmas nga Komisioni Shqiptar i Letrave me Vlerë, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe nga Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve.

o Legjislacioni u miratua në shkurt të vitit 2007 duke vendosur kërkesën për një kapital minimal në shumën 370 milion lekë (4.8 milion USD) për siguruesit e jo-jetës. Siguruesit u lejuan të përmbushnin kërkesën e re me këste duke filluar në muajin maj të vitit 2007 dhe duke përfunduar jo më vonë se në muajin prill të vitit 2008.

o Autoriteti i ri i Mbikëqyrjes Financiare ka nxjerre një numër rregulloresh që kanë hyrë në fuqi që nga muaji shkurt 2007, të cilat po vëzhgohen dhe monitorohen më me rreptësi se sa është vepruar në rastin e udhëzimeve të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Më kryesorja ndër risitë e AMF-së ka qenë prezantimi në fund të vitit 2007 i mbikëqyrjes online të shitjes së policave të sigurimit motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta. Kjo është shoqëruar me krijimin e Qendrës Kombëtare të të Dhënave, si regjistër shitjesh për MTPL-në e detyrueshme.

o Në vitin 2005 të ardhurat nga primet e tregut të jo-jetës pësuan një rënie me 6.2%, kryesisht si rezultat i uljes së nivelit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta. Në vitin 2007, që ishte viti i parë i plotë i funksionimit të AMF-së, primi i sigurimit të jo-jetës u rrit si volum me mbi 30% kryesisht si rezultat i zbatimit më efikas të tarifave motorike. Primet e MTPL-së u rritën me mbi 55%.

o Tregu Shqiptar i Sigurimeve përbëhet tani nga dhjetë shoqëri, shtatë prej të cilave janë krejtësisht shoqëri të sigurimit të jo-jetës, dy janë krejtësisht shoqëri të sigurimit të jetës dhe

një është e përbërë. Gjatë vitit 2007 Viena Insurance Group, Uniqa dhe Aspis Group blenë aksione të tre shoqërive shqiptare respektivisht. o Shoqëria monopol ish-shtetërore, INSIG, u privatizua pjesërisht në vitin 2004, ndërkohë që ishte planifikuar të shitej plotësisht në një të ardhme të afërt. Është planifikuar përsëri të shitet pjesa e mbetur prej 61% e aksioneve shtetërore në vitin 2008.

o Tatimi i fitimit u ul nga 23% në 20% duke hyrë në fuqi që nga muaji janar i vitit 2006 dhe më vonë u ul më tej në 10% duke hyrë në fuqi në muajin janar të vitit 2008. Në të njëjtën kohë, TVSH-ja prej 20% që zbatohet në të gjitha primet e jo-jetës (me përjashtim të kartonit jeshil) mbetet në fuqi. AMF-ja e re financohet kryesisht nëpërmjet 1.5% te primeve të sigurimit.


E Ardhmja

Shqipëria mbetet një ndër tregjet më të vogla të sigurimeve në botë: vendi është i varfër; blerja e sigurimit nuk përbën karakteristikë të kulturës tregtare dhe ekziston një mungesë e ekspertizës profesionale në këtë industri. Klasat motorike, si një karakteristike e zakonshme e një tregu të pazhvilluar, përbëjnë 70% të primeve në total. Por, gjatë viteve të fundit janë rritur mjaft shpresat për zhvillim: ligji i ri i sigurimeve ka hyrë në fuqi që në vitin 2004, në vitin 2006 është krijuar një organ i ri dhe efektiv i mbikëqyrjes dhe, së fundi, në treg kanë hyrë një numër kompanish të huaja. Politikat e brendshme kanë qenë relativisht të qëndrueshme për disa vite. Ka një rritje të besimit të biznesit që ndihmohet nga integrimi i mëtejshëm i vendit në Evropë nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit të nënshkruar në vitin 2006, si dhe nga ftesa zyrtare në muajin prill 2008 për anëtarësim në NATO. Në rast se rregullatori do të jetë i aftë të miratojë gamën e klasave shtesë të detyrueshme dhe gjysmë të detyrueshme që janë planifikuar për vitin 2008 dhe 2009, duke

përfshirë po pa u kufizuar vetëm në kompensimin e aksidenteve në punë, atëherë tregu ndoshta do të jetë përgatitur të ecë përpara në planin afatmesëm.

Fakte Kryesore

Grafiku i mëposhtëm tregon rritjen e tregjeve të sigurimit të jetës, të jo-jetës dhe të aksidenteve personale e të shëndetit për periudhën 2003 deri në vitin 2007.



o Kur ky raport ishte duke u përgatitur, kursi i këmbimit ka qenë 1 USD : 77 Lekë dhe ky kurs është përdorur për të gjitha konvertimet ekzistuese. Për vitet e mëparshme është përdorur kursi mesatar vjetor për vitin në fjalë (shih Kontrollin e Valutës dhe të Këmbimit në seksionin e Politikës dhe të Ekonomisë të këtij raporti). Në të njëjtën kohë, kurset e tjera të këmbimit ndërmjet valutave përkatëse ishin 1 EURO : 122 Lekë dhe 1 EURO : 1.58 USD.

o Shqipëria është një vend Ballkanik që ndodhet në brigjet lindore të Adriatikut ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Vendi ka një sipërfaqe prej 11,100 milje katrore (28,748 kilometra katrore), 75% e të cilave është malore. Kryeqyteti është Tirana.

o Numri i popullsisë banuese në vitin 2006 është vlerësuar 3.1 milion. Megjithatë, një shifër e vlerësuar prej 750,000 shqiptarësh punojnë përkohësisht jashtë vendit dhe një numër shtesë prej 2.3 milion shqiptarësh jetojnë në vendet fqinje në Maqedoni dhe në

Serbi. Në muajin shkurt 2008 Kosova fqinje, një provincë e Serbisë, por e administruar si protektorat nga Kombet e Bashkuara, shpalli pavarësinë e njëanshme si shtet i pavarur. Kosova përbëhet më së shumti nga popullsi etnike Shqiptare.

o Shqipëria ka qenë pjesë e Perandorisë Otomane nga viti 1385 dhe fitoi pavarësinë e saj vetëm në vitin 1912. Pas Luftës së Dytë Botërore, vendi iu nënshtrua formës më ekstreme të komunizmit që u vendos në ndonjë vend Evropian. Rënia e komunizmit në vitin 1991 u pasua nga një dekadë paqëndrueshmërie politike, e cila kërkoi ndërhyrjen e ushtrisë Italiane në dy raste, ku ai më i fundit ishte në vitin 2007 kur rrëzimi i skemave “piramidale” e çoi vendin në kushtet e një praplufte civile.

o Qeveria ekzistuese i përket koalicionit të qendrës së djathtë që udhëhiqet nga Partia Demokratike e Shqipërisë (PD) që fitoi zgjedhjet në vitin 2005. Qeveria po vazhdon përgatitjet e vendit për t'u integruar në Bashkimin Evropian dhe, për rrjedhojë, ajo është e angazhuar në çrrënjosjen e korrupsionit dhe të krimit të organizuar që kishte pllakosur administratën e mëparshme socialiste.

o Likuidimi i industrive shtetërore të prodhimit e ka detyruar pjesën më të madhe të popullsisë që t'i kthehet bujqësisë si burim jetese. Prandaj, bujqësia përbën përafërsisht 25% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe 60% të punësimit. Pavarësisht rritjes konstante të Prodhimit të Brendshëm Bruto me rreth 6% në vit, Shqipëria mbetet vendi i dytë më i varfër në Evropë pas Moldavisë.

o Shqipëria ka një ndër tregjet më të vogla të sigurimeve në botë. Në vitin 2007 e ardhura nga primi i sigurimit të jo-jetës (duke përfshirë sigurimin e Aksidenteve Personale dhe sigurimin e Shëndetit) arriti në shumën 5.5 miliard lekë (61.07 milion USD), ku sigurimet motorike përbënin mbi 75%. Si pasojë e varfërisë dhe mungesës së një kulture të

sigurimit, primet e sigurimit vullnetar përbënë vetëm 30% të totalit të primeve të nxjerra. Në vitin 2007 primet e sigurimit të jo-jetës, pa përfshirë Aksidentet Personale dhe sigurimin e Shëndetit, zunë vetëm 0,52% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, e barabartë me 18.37 USD për frymë.

o Tregu i sigurimit të jo-jetës përbëhet nga INSIG-u, që është pjesërisht në pronësi të shtetit dhe shtatë konkurrentë të sektorit privat, aksionet e tre prej të cilëve u blenë nga të huajt gjatë vitit 2007.

o Sigurimi i papërfshirë nuk pranohet, përveç rasteve të marinës dhe aviacionit.

o Të vetmet klasa tarifash janë sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe kartoni jeshil.

o Shoqëritë e huaja janë të lira të hyjnë në tregun Shqiptar të sigurimeve ku ata mund të vendosin filialet dhe degët që janë tërësisht në pronësi të tyre.

o Pjesa më e madhe e veprimtarisë realizohet nëpërmjet forcave të veta të shitjes së shoqërive dhe nëpërmjet agjencive. Nuk ka brokera vendorë sigurimi. Volumi në rritje i sigurimeve të lidhura me huatë realizohet nga bankat.

o Rreziku kryesor natyror është tërmeti, veçanërisht përgjatë rripit bregdetar dhe në pjesën veriore të vendit. Shumë pjesë të vendit janë të prekshme nga përmytjet.

o Klasat e detyrueshme janë sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe sigurimi i aksidenteve personale për pasagjeret e transportit hekurudhor. Kartoni Jeshil për sigurimin motorik ndërkombëtar duhet blerë përpara largimit nga Shqipëria. Kompensimi i të punësuarve aktualisht sigurohet nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore.

o Nuk ekziston një treg i brendshëm i risigurimit. Të gjitha mbrojtjet nëpërmjet risigurimit bëhen jashtë vendit.

...Vijon nga numri I kaluar

Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

Shënime të udhëzimeve për licencimin e instituteve të pensionit.

III. Kërkesat për licencim

1. Dispozitat ligjore mbi licencimin

1. Në interes të transparencës, të vërtetësisë ligjore dhe qëllimeve të përmendura në parathënie të këtyre udhëzimeve, rregullat e licencimit përcaktohen me anë të legjislacionit. Dispozitat ligjore përcaktojnë strukturën e procesit të licencimit dhe gjithashtu përcaktojnë kompetencat, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proces. Dispozitat ligjore përgjithësisht ndikojnë vetëm në institutet e pensionit, por në disa juridiksione ato aplikohen edhe nga planet e pensionit, veçanërisht kur çdo plan është i lidhur me një institut të vetëm pensioni.

2. Dispozitat ligjore përcaktojnë tipet e planeve apo fondeve të pensionit që mund të krijohen [p.sh plane me përfitime të përcaktuar (DB), të përziera, hibride ose kontribute të përcaktuara (DC)] dhe strukturën ligjore të instituteve të pensionit (p.sh kujdestari, fondacion, organizatë jo-fitimprurëse, sh.a, sh.p.k).

2. Dokumentet e qeverisjes

3. Dokumentet e qeverisjes së instituteve ose planeve të pensionit mund të përmbajnë statutin, aktet e themelimit, aktin e kujdestarisë ose rregullat e planit të pensionit, në varësi të dispozitave ligjore përkatëse apo strukturës ligjore të institutit të pensionit.

4. Qëllimi i institutit të pensionit dhe i planit të

biznesit duhet të jetë një burim i sigurt i të ardhurave të pensionit.

5. Dokumentet e qeverisjes specifikojnë, nëse garancitë e kompensimit, përfitimit ose premtimet janë apo jo të kushtëzuara nga efektshmëria e fondit apo e planit. Në rastin e premtimeve të pakushtëzuara, është e nevojshme që dokumentet e qeverisjes të përcaktojnë nëse punëdhënësi sponsorizues dhe/ose anëtarët e planit mund të kërkojnë t'i rrisin kontributet e tyre në mënyrë që të rregullojnë balancën financiare të fondit apo planit.

6. Gjithashtu, është e nevojshme që dokumentet e qeverisjes të përcaktojnë (i) strukturën ligjore të institutit të pensioneve, strukturën e kapitalit dhe qëllimin; (ii) kontributet dhe përfitimet; (iii) mjetet që do të përdoren për sigurimin e ndarjes juridike ndërmjet aktiveve të planit/fondit të pensionit dhe shoqërisë së administrimit të pensionit dhe gjithashtu ndërmjet planeve/fondeve të tjera të administruara nga shoqëria; (iv) strukturën organizative; (v) strukturën qeverisëse, rolin dhe përgjegjësitë e organizmave qeverisës; dhe (vi) kontratën e anëtarësisë/binjakëzimit, nëpërmjet të cilave instituti i pensionit lejon të administrohet nga një shoqëri tjetër.

3. Menaxhimi i riskut, mekanizmat e raportimit dhe të auditimit

7. Është e nevojshme që të vendosen masa për një auditim të herëpashershëm dhe për raportim nga ana e audituesit, aktuarit (planet DB) dhe organizmave qeverisës, në mënyrë që të arrihet kështu një mbikëqyrje e përshtatshme, transparencë dhe veprimtari koherente e shoqërisë.

8. Rregullat për pasqyrimin e informacionit rrisin transparencën e veprimtarive të

organizmave qeverisës, ashtu siç bën të njëjtën gjë edhe krijimi i procedurave organizative dhe administruese. Për arsye të përmendura më lart është e pëlqyeshme që çdo fond apo plan pensioni i administruar nga një institut pensioni, të ketë një llogari të veçantë.

9. Procedura e menaxhimit të riskut kontribuon në veprimtari koherente të shoqërisë dhe gjithashtu ndihmon në krijimin e masave dhe sistemeve të duhura menaxhuese të riskut. Këto procedura përfshijnë mekanizma që identifikojnë dhe adresojnë konfliktet e interesit dhe risqet e operimit, siç janë ato në lidhje me mosfunksionimin e teknologjisë. Gjithashtu nevojiten edhe disa mjete specifike për menaxhimin dhe vlerësimin e riskut të investimit dhe risqeve të tjera të lidhura me fondin apo planin e pensionit.

4. Politikat financuese

10. Politikat financuese përshkruajnë në detaj strategjinë që instituti i pensionit ndjek për t'u përputhur me nivelet e kërkuara të financimit, të cilat janë vendosur nga rregullatori përkatës. Në rastin e planeve DB dhe planeve hibride/të përziera, politikat financuese bazohen në metodat dhe teknikat aktuale të miratuara.

11. Në interes të transparencës, është themelore që çdo fond apo plan pensioni i administruar nga një institut pensioni, t'i ketë të përcaktuara politikat dhe metodat e tij financuese.

5. Politikat e investimit

12. Politikat e investimit përcaktojnë qëllimet financiare të fondit apo të planit të pensionit. Gjithashtu, ato përcaktojnë parimet e investimit, shpërndarjen strategjike të aktiveve, realizimin e qëllimeve dhe synimet për menaxhimin e riskut, procesin e zgjedhjes së administruesit të aktiveve, gjithashtu mekanizmat e monitorimit dhe rishqyrtimit të veprimtarisë, mekanizmat e ndryshimit të

shpërndarjes së aktiveve dhe administruesve të tyre.

13. Paraqitja e politikave të investimit si pjesë e aplikimit për licencim, lejon që autoriteti licencues të bëjë vlerësimin, nëse këto politika janë të përshtatshme dhe nëse janë në të njëjtën linjë me qëllimet dhe përgjegjësitë e fondit dhe kërkesat përkatëse ligjore. Gjithashtu, ajo lehtëson mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve investuese të instituteve të pensionit pas licencimit. Është veçanërisht e rëndësishme që politikat investuese të jenë në përputhshmëri me përgjegjësitë financiare të fondit apo planit të pensionit.

6. Kërkesat e kapitalit

14. Në disa juridiksione të veçanta, institutet e pensionit duhet të kenë një shumë minimale të kapitalit fillestar. Në rastin kur ndodh kjo, shumata minimale e kapitalit fillestar varet nga llojet e risqeve të menaxhuara, nga shtrirja e përgjegjësisë së institutit të pensionit për çdo garanci kompensuese/përfituese ose nga keqadministrimi dhe gjithashtu varet edhe nga madhësia e fondit që administrohet. Në këto juridiksione, autoriteti licencues duhet të ketë prova që kërkesat e kapitalit janë përmbushur (në rastin kur këto kërkesa nuk janë adresuar nga mbikëqyrësi tjetër i institutit financiar).

7. Qeverisja

15. Instituteve të pensionit normalisht ju kërkohet të paraqesin të dhëna mbi strukturën qeverisëse, si emrat, CV-të dhe të dhënat kontaktuese të anëtarëve të organizmave qeverisës/drejtues. Këto të dhëna duhet të përfshijnë gjithashtu certifikatat profesionale dhe një deklaratë që konfirmon që personat nuk kanë precedent penal për krime financiare apo pronësie dhe nuk janë në proces gjyqimi. Informacioni i kërkuar mund të përfshihet në dokumentet e mëposhtme, të cilat do të kërkohen të paraqiten nga instituti i pensionit:

- o statutet dhe dokumentet e planit apo institutit;
- o kodin e sjelljes së anëtarëve të organizmave të qeverisjes/drejtimit dhe të stafit plotësues, që adreson ndër të tjera edhe konfliktet e interesit e emërimet e ndaluara;
- o kontratat e shërbimit të palëve të treta;
- o të dhëna për menaxhimin e riskut, për mekanizmat e raportimit dhe të auditimit.

16. Për qëllime mbikëqyrjeje dhe në interes të transparencës, institutet e pensioneve mund të kërkojnë të paraqesin një ose më shumë nga këto: të dhënat e kontaktit të sponsorit të planit, të aktuarit, të auditit të pavarur dhe të kujdestarit.

17. Në disa juridiksione, kërkesat për qeverisjen e shoqërisë mund të marrin trajtën e kufizimeve formale, në bazë të të cilave administruesi i planit apo fondit të pensionit është i ndaluar t'i ushtrojë kompetencat e tij që t'i adresojë investimet drejt palëve me të cilat ai ka lidhje. Në nota më të përgjithshme, këto kërkesa reflektohen në ndalimin me ligj për të marrë pjesë në ndonjë transaksion në lidhje me aktivet e planit apo të fondit të personave që janë, në një mënyrë apo tjetër, të lidhur me institutin e pensioneve.

18. Në mënyrë që të evitohen konfliktet e interesit, që të rritet transparenca dhe që të mbrohen interesat e anëtarëve të institutit të pensionit dhe të përfituesve, është e pëlqyeshme një ndarje ndërmjet stafit që merret me investimet dhe atij përgjegjës për kryerjen e marrëveshjeve dhe kontabilitetin. Kjo ndarje do të reflektohet në strukturën organizative të institutit të pensionit.

19. Në rastet kur marrëveshjet kontraktuese bëhen të dukshme gjatë procedurës së licencimit, ato do të qartësojnë në kontratë se çfarë detyrash do të ketë gjithsecili. Informacionet mbi marrëveshjet kontraktuese e lejojnë autoritetin të vlerësojë nëse aplikuesi

nuk e kalon kufirin e kontraktimit, nuk e shkel detyrën për të monitoruar dhe për të mbikëqyrur siguruesin e shërbimit të jashtëm e që nuk e liron veten nga përgjegjësia e aktiviteteve të kontraktuara.

8. Plani i biznesit

20. Plani i biznesit përshkruan aktivitetin e propozuar të institutit të pensionit në vitet e para të tij pas krijimit. Projektet e zhvillimit të aktivitetit përfshijnë të dhëna mbi nivelin e kontributeve, aktivet nën administrim, pagesat e përfitimeve dhe shpenzimet operative për çdo fond apo plan që do të menaxhohet, të dhëna mbi parametrat e numrit të parashikuar të anëtarëve të planit, të dhëna mbi grupin e shënjestruar (me çfarë të ardhurash, çfarë profesioni, etj) dhe periudhën e menduar për të paguar mbrapsht kostot e themelimit që mund të përfshihet në dokumentet në lidhje me zhvillimet e projektuara të planit apo të fondit.

9. Heqja e licencës

21. Është e nevojshme që ligji të përcaktojë rrethanat sipas të cilave një licencë mund të hiqet ose mund të konsiderohet si e tillë. Kjo duhet të ndodhë në situatat e mëtejshme: (i) kur instituti nuk i përmbush më kërkesat e licencimit; (ii) kur shkel rëndë ligjin; (iii) kur instituti i pensioneve shprehimisht heq dorë nga licenca; (iv) kur licenca nuk përdoret brenda një periudhe të caktuar kohe; (v) kur nuk e ushtron më veprimtarinë; ose (vi) kur instituti i pensioneve e ka marrë licencën në bazë të informatave të rreme. Në juridiksionet ku licenca mund të hiqet, kur fondi i pensioneve nuk e përdor atë brenda një periudhe të caktuar kohore, atëherë ligji duhet ta përcaktojë qartë këtë periudhë.

22. Drejtësia e kërkon që të ekzistojnë mekanizma ligjore korigjuese, në rastin kur instituteve të pensionit ju është hequr licenca në mënyrë të detyrueshme.



IV. Kompetencat dhe detyrimet e autoritetit licencues

10. Roli i autoritetit licencues në çështjet mbikëqyrëse

23. Këto udhëzime theksojnë rëndësinë e lidhjes ndërmjet licencimit të instituteve të pensionit dhe mbikëqyrjen e tyre të vazhdueshme, sepse të dyja janë të rëndësishme për të arritur qëllimet e përmendura në fillim të këtyre udhëzimeve. Në pjesën më të madhe të rasteve, autoriteti licencues dhe ai mbikëqyrës është një institucion i vetëm, duke siguruar kështu një përputhshmëri ndërmjet kërkesave dhe rregullave të licencimit dhe qëllimeve për mbikëqyrjen e vazhdueshme. Megjithatë, kur ato janë dy institucione të ndryshme, këshillimi i mbikëqyrësit për aplikimin e licencës kontribuon në përputhshmërinë e praktikës së licencimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme.

11. Qartësia e procedurës së aplikimit për licencë

24. Në interesin e aplikuesve dhe autoriteteve licencuese dhe në mënyrë që të sigurohet një proces licencimi sa më praktik, është e nevojshme që ligji të përcaktojë hapat e ndryshëm në procesin e licencimit dhe të përcaktojë kompetencat e autoritetit licencues. Këto kompetenca mund të përfshijnë një rishikim të dokumenteve dhe inspektim në terren para ose mbrapa licencimit. Gjithashtu, duhet të përcaktohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit licencues dhe të aplikuesit për licencë.

25. Hapat e procesit të aplikimit, të cilat duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë, përfshijnë fillimisht të dhënat dhe dokumentet që autoriteti licencues kërkon nga aplikuesi. Hapa të tjera që duhen përcaktuar, përfshijnë ato, nëse autoriteti mundet apo jo të kërkojë të dhëna të tjera shtesë ose të kërkojë korrigjimin

e aplikimeve të mangëta dhe të përcaktojë kohën brenda së cilës aplikuesi duhet t'u përgjigjet këtyre kërkesave. Gjithashtu është e nevojshme për aplikuesin të dijë se çfarë lloj vendimesh mund të marrë autoriteti licencues, cilat dokumente do të rishqyrtohen, nëse do të ketë inspektim në terren dhe deri në çfarë mase autoriteti licencues mund të kryejë kontrolle me autoritete të tjera publike, duke pasur gjithmonë si qëllim aplikimin për licencë. Përfundimisht, aplikuesi duhet të dijë se si do t'i njoftohet vendimi i autoritetit licencues dhe të njohë procesin e apelimit, nëse ndihet i pakënaqur nga vendimi.

12. Paraqitja e dokumenteve

26. Në mënyrë që autoriteti të vlerësojë nëse instituti i pensionit i përmbush kriteret e licencimit dhe në mënyrë që të lehtësojë mbikëqyrjen në terren, instituti duhet të paraqesë të dhëna me shkrim për kërkesat e përmendura në seksionin III. Këto të dhëna përfshijnë dokumentet e qeverisjes,

dokumentet që vërtetojnë që instituti i përmbush kërkesat për kapital (nëse ka), strukturën e qeverisjes, mekanizmat e menaxhimit të riskut dhe mekanizmat e raportimit dhe auditimit. Mekanizmat e auditimit, nëse nuk kërkojnë përpara dhënies së lejes për ushtrimin e biznesit, duhet të krijohen dhe të zhvillohen në një fazë më të vonë. Dokumente të tjera që duhen paraqitur përfshijnë dokumente që përcaktojnë politikën financuese, politikën e investimit, kërkesat për kapital (nëse ka) dhe planin e biznesit.

13. Vlerësimi i aplikimit për licencë

27. Meqë qëllimi i vlerësimit të licencimit ndryshon sipas rasteve, është e rëndësishme që autoriteti licencues të ketë të drejtën të vlerësojë aspekte të ndryshme të institutit të pensioneve. Këto të drejta duhet të përcaktohen qartë në legjislacion. Intensiteti i vlerësimit të

licencimit, mund të varet nga përmasat dhe kompleksiteti i veprimtarisë së institutit. Qëllimi i këtyre kompetencave, jo vetëm që duhet të jetë i përcaktuar qartë në aktet ligjore përkatëse, por gjithashtu duhet të kërkohet që këto kompetenca të ushtrohen duke trajtuar të gjitha palët në mënyrë të njëjtë dhe në përputhje me ligjin, duke ndjekur kështu jo vetëm procedura që janë transparente, por edhe praktika të mirëvendosura dhe transparente. Këto praktika do të aplikohen edhe në shënimet e udhëzimit IV. 15 (“Kompetencat për të refuzuar, modifikuar ose hequr licencën”).

28. Autoriteti licencues mund të ketë nevojë që të vlerësojë ekspertizën dhe integritetin e drejtorëve të institutit të pensioneve dhe administruesve të lartë me anën e provës së principit për “fit and proper”, përfshirë këtu edhe konfliktet e mundshme të interesit, duke vlerësuar aftësitë dhe eksperiencën në veprimtaritë e caktuara financiare që korrespondojnë edhe me aktivitetin që do të ushtrojë aplikuesi. Gjithashtu, autoriteti duhet të kërkojë vërtetim që nuk ka precedentë penal për aktivitete të paligjshme apo që nuk janë marrë vendime gjyqësore korrektive ndaj individëve që do të kenë poste të rëndësishme në institutin e pensionit të aplikuesit në fjalë, gjë që do i kishte bërë këto individë të papërshtatshëm për të mbajtur pozicione të tilla.

29. Autoriteti licencues, kur është e përshtatshme, mund të ketë nevojë që të vlerësojë përshtatshmërinë e aksionerëve të institutit të pensionit, në të njëjtën mënyrë siç vlerëson edhe drejtorët dhe administruesit e lartë të institutit.

30. Normalisht, autoriteti licencues në mbështetje të planit strategjik të propozuar, duhet të ketë edhe kompetencën për të vlerësuar forcën financiare të aplikuesit

(përfshirë këtu edhe nëse janë përmbushur kërkesat e detyrueshme për kapital), për të vlerësuar se sa të përshtatshme janë politikat financiare së bashku me teknikat dhe metodat e aktuaristikës, dhe për të vlerësuar strukturën operative e atë të qeverisjes.

31. Vlerësimi mund të përfshijë edhe një ekzaminim të mekanizmave në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve të paligjshme të kryera nga kushdo brenda institutit të pensionit dhe gjithashtu edhe të mekanizmave në lidhje me papërgjegjshmërinë e funksioneve të propozuara kontraktuese.

32. Në juridiksionet ku autoriteti i licencimit mund të imponojë kushte mbi aplikuesin e licencës, kompetencat dhe kufizimet për t'i imponuar këto kushte, duhet të përcaktohen me ligj, në mënyrë që të sigurohet transparencë, drejtësi dhe vërtetësi ligjore në procesin e licencimit. Kushtet mund të imponohen, të modifikohen ose të hiqen pas një kërkesë nga ana e aplikuesit për

licencim ose nga ana e vetë autoritetit licencues (nëse është e nevojshme në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës në rastin kur ato janë dy institucione më vete).

14. Materialet udhëzuese

33. Procesi i aplikimit për licencë në shumë vende përfshin paraqitjen dhe analizimin e të dhënave komplekse. Për këtë është e nevojshme që të përgatiten materiale udhëzuese për vlerësuesin e licencimit, i cili punon për autoritetin licencues dhe gjithashtu edhe për aplikuesin. Këto materiale shkurtojnë kohën që duhet për të vlerësuar një aplikim për licencë dhe lehtësojnë punën e vlerësuesit. Materialet udhëzuese më ndihmuese për vlerësuesin janë listat e detyrave dhe manualet, ose një grup procedurash për inspektimet në terren dhe jo vetëm.

34. Në të njëjtën mënyrë, procesi i licencimit mund të bëhet më i lehtë për aplikuesin, nëse edhe atij do t'i jepeshin materiale udhëzuese. Materiale të vlefshme në këtë rast mund të jenë një listë me të gjitha kërkesat që ato duhet të plotësojnë, formën e aplikimit dhe materialin shpjegues, bashkëlidhur e gjithashtu materialin shpjegues se si aplikuesi duhet t'i përmbushi kriteret e licencimit.

15. Kompetencat për të refuzuar, modifikuar ose tërhequr licencën

35. Procesi i licencimit është më efektiv, nëse autoriteti licencues ka të drejtën për të refuzuar aplikimin për licencimin, në rastin kur aplikuesi nuk i përmbush të gjitha kriteret që i kërkohen. Është e rëndësishme që autoriteti licencues të mos ushtrojë të drejtën e tij të vetëgjyqimit duke marrë vendime të pa baza, por të mbështetet në përmbushjen e kërkesave ligjore. E drejta për të refuzuar aplikimin për licencë duhet të ushtrohet në përputhje me praktikën transparente, të cilat i bëhen të ditura paraprakisht institutit që po aplikon për licencë. Transparenca gjithashtu kërkohet edhe në vendimet për refuzim dhe praktikën duhet të jenë në përputhje me ligjin. Qëllimi i vetëgjyqimit që mund të ushtrohet nga autoriteti licencues duhet të parandalohet apo limitohet sa më shumë që të jetë e mundur.

36. Në mënyrë që të arrihet një proces transparent dhe i drejtë, është e nevojshme që autoriteti licencues ta informojë saktësisht aplikuesin për arsyet që çuan në vendimin për refuzimin e licencës.

37. Në sistemin licencues, ku autoriteti ka të drejtën të imponojë kushte në përdorimin e licencës, normalisht ai duhet të ketë edhe kompetencën për t'i modifikuar këto, nëse e kërkon situata.

38. Autoriteti licencues gjithashtu ka edhe të

drejtën që të heqë licencën, por vetëm në rrethana të veçanta që janë specifikuar qartë nga ligji. (shiko udhëzimin 9 për heqjen e licencës).

39. Autoriteti licencues duhet që ta informojë në mënyrë të qartë dhe në kohë institutin e pensionit për arsyet e sakta që çuan në marrjen e vendimit për heqjen e licencës.

40. Instituteve të pensionit që ju është hequr apo modifikuar licenca, duhet të jetë e mundur që të rishikohet vendimi për heqjen apo modifikimin e licencës (apelimi administrativ) ose të shqyrtohet nga gjykata (apelimi gjyqësor). Mekanizmi i rishqyrtimit duhet të jetë transparent dhe duhet të përfshijë masa të duhura mbrojtëse për modifikimin dhe veçanërisht për heqjen e autorizimit ose humbjes së përfitimeve tatimore. Duhet të kushtohet kujdes që kjo heqje apo humbje e sipërpërmendur të mos të ndodhë përpara mbarimit të mekanizmit të rishqyrtimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa do të rezultonte në dëme të pandreqshme, veçanërisht kundrejt anëtarëve të planit të pensionit. Mekanizmat e rishqyrtimit duhet të evitojnë procedura dhe kërkesa që nuk duhet të jenë domosdoshmërisht të kushtueshme dhe të ngarkuara (përsëri, kushtëzohet nga masat e duhura mbrojtëse për anëtarët e planit).

41. Mundësia për të nisur një proces apelimi gjyqësor, apo administrativ, i nxit autoritetet licencuese që të marrin vendime të cilat i rezistojnë shqyrtimeve juridike, ndërsa nga ana tjetër i japin mundësi instituteve të pensionit të shprehin pakënaqësinë e tyre, në mënyrë që të sigurohen që vendimet e marra janë të drejta.

Për këtë numër punuan:

**E. Shehi, R. Guri, R. Eltari,
E. Sherri, E. Kokona**

